



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë

Mbledhja nr. 3

Prishtinë, më 25.5.2021, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Haki Abazi, Xhavit Haliti, Branislav Nikoliq, Adelina Grainca, Dimal Basha, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi, Kujtim Shala, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

Në këtë takim ishte e ftuar: znj. Donika Gërvalla-Schwarz, zëvendëskryeministre dhe ministre e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Pjesëmarrës të tjerë: Sharr Jakupi, shef i kabinetit të MPJD; Ermira Gashi, Kuvendi i Kosovës; Arbenita Mjekiqi, Kuvendi i Kosovës; Dajana Berisha, FIQ; Lirika Agusholli, GLPS; Liridona Gashi, Kuvendi i Kosovës; Butrint Berisha, PIPS, si dhe media.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Haki Abazi, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës:

Raportim i ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, znj. Donika Gërvalla-Schwarz, lidhur me planin legjislativ të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe prioritetet e saj.

Haki Abazi, njoftoi se nga mbledhja e kaluar është përcaktuar rendi i ditës për këtë takim dhe se sipas Programit legjislativ të vitit 2021, janë paraparë për shqyrtim në kompetencë të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë 5 projektligje. Ai kërkoi nga ministrja që ta njoftojë komisionin, lidhur me këto projektligje, për nevojën e hartimit të këtyre projektligjeve, se cilat ligje do të shfuqizohen dhe se a do të merren parasysh rekomandimet nga mbikëqyrjet e zbatimit të ligjeve të bëra nga ky komision.

Ai, më tej, tha se do të tentohet që të ngrihet standardi i komunikimit ndërmjet legjislativit dhe ekzekutivit. Do të ketë raste të komunikimeve të ndryshme në mes të ministres dhe komisionit, duke e përfshirë edhe faktin që është përcaktuar se çdo 3 muaj të kemi raportime të ministres, ku do të shkëmbehen informacione për ta arritur një koherencë dhe kohezion të plotë të funksionimit.

Donika Gërvalla, njoftoi se plani legjislativ i ministrisë është përgatitur në pajtim me nenet 5 dhe 6 të Rregullores nr. 13/2013 për shërbimin ligjor qeveritar, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 11 maj 2021.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi, në kontestin e aderimit në Bashkimin Evropian, njoftoi se MPJD, më 21.3.2019, kishte nënshkruar Marrëveshjen në kontekst të aderimit në BE, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi. Ky projektligji ishte miratuar edhe nga Qeveria e kaluar dhe i është përcjellë Kuvendit, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, ky projektligj nuk është miratuar.

Në vijim, tha se qëllimi i Projektligjit për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara, është krijimi i mekanizmave sa më efikas, në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sa i përket zbatimit të sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara, në fushën e luftimit të terrorizmit dhe të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Sa i përket Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm, tha se qëllimi i hartimit të këtij projektligji lidhet drejtpërdrejt me objektivat e Qeverisë për krijimin e një shërbimi të jashtëm bashkëkohor, funksional, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritokraci. Projektligji për Shërbimin e Jashtëm është fuzion i ligjeve kryesore, të cilat e kanë rregulluar deri më tani Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Në këtë projektligj parashihen të mishërohen rregullat dhe parimet thelbësore të marrëdhënieve ndërkombëtare të përmbajtura në konventat kryesore ndërkombëtare të kësaj fushe, si dhe do të përcaktohen ndryshimet thelbësore në strukturën e brendshme organizative të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Më tej, tha se nevoja për nxjerrjen e Projektligjit për Diasporën, konsiston në avancimin e kornizës ligjore, për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës. Me këtë projektligj synohet përmirësimi i aktivitetit që konsiston në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar dhe kulturor të pjesëtarëve të diasporës, forcimin e lidhjeve të tyre me Kosovën, nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në mësimin plotësues dhe në aktivitetet rinore, organizimin sa më të mirë të mësimit të gjuhës dhe kulturës kombëtare për fëmijët nga diaspora, si dhe promovimin dhe nxitjen e investimeve të diasporës. Një theks i veçantë, me këtë projektligj i është kushtuar definimit të statusit dhe rolit të qendrave kulturore.

Për Projektligjin për protokollin e shtetit, tha se protokollin si shërbim profesional paraqet “shtyllën kurrizore” në jetën e përditshme, si për individin, ashtu edhe për institucionin. Protokollin monitoron dhënien e privilegjeve dhe imuniteteve diplomatike të zbatuara në Kosovë për misionet e huaja diplomatike dhe konsullore, organizatat ndërkombëtare dhe stafin e tyre në bazë të konventave ndërkombëtare, marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, praktikave ndërkombëtare dhe ligjit vendor të aplikueshëm. Protokollin i shtetit gjithashtu kryen regjistrimin e stafit të misioneve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare dhe rregullon pranimin e atashëve të fushave të ndryshme. Në këtë projektligj është paraparë edhe protokollin diplomatik, i cili dallon nga ai shtetëror.

Haki Abazi, lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi, ”Në kontestin e aderimit në Bashkimin Evropian”, pyeti për gatishmërinë dhe procesin e palës malazeze në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

Lidhur me Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm, pyeti: A do të bëhet rishikimi i prezencës së Kosovës në shtetet e ndryshme të botës dhe me çfarë kriteresh do të përcaktohen, nëse prezenca e tanishme ka qenë e dobishme dhe strategjike dhe cilat vende do të shqyrtohen me prioritet për hapjen e ambasadave apo konsullatave tjera?

Cili do të jetë proporcioni i stafit diplomatik politik, në raport me ata të karrierës? A është paraparë që të intensivikohet apo të shtohet numri i përfaqësimit nëpërmjet atasheve kulturorë? A është përfshirë në analizë edhe pandemia qoftë në sjelljen e diplomatëve tonë, qoftë edhe në marrëdhëniet me qeveritë dhe institucionet ku ata janë prezentë dhe a do të përfshihet kjo si pjesë e analizës së protokollit dhe Projektligjit për protokollin e shtetit?

Donika Gërvalla, sa i përket Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes me Malin e Zi, tha se kjo është një marrëveshje që është lidhur në vitin 2019 dhe është çështje formale që ratifikimi të bëhet nga ana e jonë.

Sa i përket prezencës sonë në vende të ndryshme, ajo njoftoi se Projektligji për Shërbimin e Jashtëm do të vë në pikëpyetje të gjitha ambasadat dhe konsullatat tona në vende të ndryshme. Do të merret në konsideratë secili shtet dhe do të shikohet se në çfarë konkurrence jemi me shtetet e tjera, ku do të duhej të ishim të pranishëm, por që nuk jemi.

Sa i përket proporcionit të diplomatëve politik dhe atyre të karrierës, ajo njoftoi se nuk do të tejkalohet në asnjë moment proporcioni 50/50 dhe nuk do të ketë konsuj politikë në këtë Qeveri. Nëse merren parasysh vetëm ambasadorët, atëherë proporcioni do të jetë së paku 50% diplomatë të karrierës, por nëse merren parasysh edhe konsujt, atëherë përqindja do të jetë më tepër kah diplomatët e karrierës.

Sa i përket atasheve kulturorë, tha se nuk ka një zgjidhje standarde për secilin shtet dhe ka shtete në të cilat nuk ka nevojë për atashe kulturor, por ku kemi nevojë që secili diplomat të jetë i përgatitur që të jetë përfaqësues edhe i ekonomisë edhe i kulturës së vendit tonë dhe njoftoi se ka një marrëveshje në mes të Ministrisë së Jashtme dhe Ministrisë së Kulturës, sa i përket përgatitjes dhe specifikave të tyre.

Pandemia, si në çdo sferë tjetër të jetës, ka vështirësuar punën sa i përket komunikimit, lëvizjes në mes të diplomatëve, si dhe komunikimin me shtetet pritëse. Gjatë kësaj kohe është zbehur edhe kontakti në mes të përfaqësuesve tanë jashtë vendit dhe mërgatës tonë.

Haki Abazi, pyeti lidhur me sistemin e sigurisë në komunikimin brenda ministrisë, pasi që ka pasur raportime që ky sistem nuk arrijnë standardet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht komunikimet me vende, por edhe me palët e interesit janë të limituara.

Po ashtu, pyeti: çfarë do të bëhet me konsujt e nderit dhe si do të bëhet riformimi i kësaj çështje? Pra, pasi që ka konsuj të nderit që as ne vet nuk i dimë ose nuk dihet saktësisht se cilat janë kriteret për përcaktimin e konsujve të nderit.

Donika Gërvalla, lidhur me sistemin e sigurisë së komunikimit, tha se për këtë çështje nuk do të mund të flas para kamerave, kurse sa i përket konsujve të nderit, bëri të ditur se ka kërkuar një pasqyrë të listave dhe të kriterëve, të përcaktimit të konsujve të nderit dhe atë nuk e ka gjetur brenda MPJD-së. Po ashtu, theksoi se çështja e emërimit të konsujve të nderit ka qenë më tepër çështje e rastësisë, e njohjeve personale, e vlerësimit personal të personave. Ajo, më tej, shtoi se ka nevojë për kriterë të qarta, në bazë të cilave përcaktohen konsujt e nderit.

Ariana Musliu-Shoshi, tha se raporti i prezantuar nga ministrja, është vetëm një pjesë e vogël e raportimit që realisht do të duhej të ishte në këtë komision, sepse ajo ka pasur takime bilaterale, ka pasur përfaqësim në organizata ndërkombëtare, ka pasur takime në Bruksel. Ne duam të dimë më shumë për gjendjen aktuale në ministri, për prioritetet si dhe për planin legjislativ të MPJD-së.

Lidhur me postimin e MPJD-së në “Twitter”, tha se ai ishte i pastrukturuar, i paartikulluar, ishte një anglishte skandaloze, ishte tërësisht i pakuptimtë. Po ashtu, tha se diplomacia digjitale është

një nga shtyllat e diplomacisë moderne dhe Kosova renditet e 4-ta në nivelin ndërkombëtar. Shprehu mendimin se diplomacia digjitale duhet të ruhet me shumë kujdes dhe jo të bëhen skandale të tilla.

Pyeti: Pse nuk janë shkarkuar konsujt e përgjithshëm politikë, pasi që këta nuk ekzistojnë me ligjin aktual të shërbimit të jashtëm, por janë të emëruar?

Donika Gërvalla, lidhur me postimin në “Twitter”, tha se deputetja Musliu-Shoshi ka të drejtë dhe e merr përgjegjësinë politike për atë postim, duke shtuar se përpjekja për të futur në 270 shkronja një mesazh të komplikuar, duke lënë anash të gjitha lidhëzat, ka shkaktuar një tekst të tillë. Ai mesazh dëshiron të tregojë që Kosova qëndron fort në krahun e aleatëve të saj. Diplomacia digjitale është shumë e rëndësishme dhe në asnjë aspekt nuk do të duhej të lihej pas dore.

Sa i përket konsujve politikë, tha se shkarkimi i 13 ambasadorëve dhe afati i dhënë atyre që deri më 30 gusht të ushtrojnë funksionet e tyre, me qëllim që të mos krijohet një zbrazëturë institucionale e pamundëson marrjen e hapave radikalë në shkarkimin e një numri edhe më të madh. Është e pamundur dhe Kosova nuk e ka luksin që të bëjë eksperimente shtetërore, institucionale dhe të jenë 50 diplomatë të cilët nuk janë në funksion. Prandaj, hapi i parë është shkarkimi i ambasadorëve politikë, i dyti zëvendësimi i ambasadorëve.

Ariana Musliu-Shoshi, sa i përket postimit në “Twitter”, tha se më mirë do të ishte që postimi të bëhej në gjuhën shqipe.

Sa i përket ambasadorëve politikë, shprehu mendimin se MPJD nuk e ka pasur luksin që as këta 13 t’i shkarkojë në të njëjtën kohë, e lërë më edhe konsujt e përgjithshëm.

Më tej, pyeti: Si është menduar tërheqja e ambasadorit në Mal të Zi dhe në Çeki, kur në Mal të Zi tani është një qeveri, e cila nuk është mike për Kosovën, po ashtu e kemi edhe një situatë mjaft komplekse në Çeki, ku presidenti kërkon që të tërhiqet njohja?

Çfarë sinjali i është dhënë shtetit të Australisë, ku tashmë nuk është asnjë staf diplomatik në atë shtet?

Donika Gërvalla, njoftoi se ambasadorët janë liruar nga detyra, por afati i kthimit të tyre në Kosovë është data 30 gusht. Pra, kthimi i ambasadorit aktual dhe dërgimi i ambasadorit të ri do të përfshijë fazën e plotësimit të detyrës dhe fazën e kalimit të detyrës nga njëri tek tjetri.

Vendimet i kemi marrë, pasi që jemi menduar mirë dhe kemi konsideruar se ky është hapi i duhur për të bërë reformën në shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës dhe konsiderojmë se ky ka qenë një hap i mirë.

Lidhur me mungesën e stafit diplomatik në Australi, ajo tha se këtë çështje e ka trashëguar dhe e vetmja gjë që i mbetet është që në koordinim me Qeverinë të emërojmë një ambasador të ri, i cili do të shkojë brenda afatit të caktuar.

Haki Abazi, tha se shteti i Malit të Zi është shtet mik fqinj. Aty është një qeveri e zgjedhur nga populli i Malit të Zi, është z. Dritan Abazović, zëvendëskryeministër dhe presidenti Gjukanović, që ka bërë njohjen e pavarësisë së Kosovës, ndër shtetet e para. Ai shtoi se e konsiderojmë marrëdhënien me Malin e Zi solide dhe shtet fqinj që e respektojmë plotësisht funksionimin e tij.

Gazmend Gjyshinca, pyeti ministren: Si e ka gjetur MPJD-në dhe cilat janë problemet kryesore, të cilat do të duhej të zgjidheshin?

Lidhur me Projektligjin për shërbimin e jashtëm, tha se është skeptik për afatin, i cili është ofruar në agjendën legjislativë, për shkak se është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i cili në

vetvete përfshin shumë grupe të interesit. Si do të përfshihen palët e interesit në një periudhë kaq të shkurtër dhe a ekziston tashmë një draft-ligj i përgatitur?

Donika Gërvalla, tha se ne i kemi vënë synim vetës që të jemi shumë të shpejtë në miratimin e këtij ligji, për shkak se kemi një nevojë të domosdoshme për atë ligj. Po ashtu, është edhe një pjesë të ish- Ministrisë së Diasporës, të cilët ende nuk janë të integruar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ekziston një projektligj, i cili është tentuar që të kalohet një herë në Kuvend, me ndryshime të vogla, por i cili nuk ka kaluar dhe ne do ta shfrytëzojmë rastin ta rishikojmë edhe një herë nga fillimi.

Sa i përket gjendjes në MPJD, ajo bëri të ditur se ka gjetur shkelje të ligjit, të cilat i ka pasur prioritet për t'i reviduar dhe për të vendosur ligjshmërinë. Më tutje, tha se në ministri ka pasur gradime të parregullta, ka pasur shkelje të kritereve jo vetëm për gradime, por edhe për dërgim të personelit që shërben jashtë vendit. Çështja e rotacionit në kuadër të MPJD-së, në disa raste, është tepruar, pasi që ka mandate të stërzgjatura dhe ka njerëz të cilët që nga viti 2008/2009 nuk iu ka ardhur radha që të përfaqësojnë vendin jashtë. Kjo ka shkaktuar një atmosferë jo të shëndoshë në mes të punonjësve të MPJD-së.

Time Kadrijaj, tha se ky është një fillim i bashkëpunimit dhe se lidhshmëria në mes të komisionit dhe ministrisë është qenësore, se po nuk bashkëpunuam, nuk do të ketë ndonjë efekt pozitiv.

Sa i përket procedimit të projektligjeve, tha se ajo çfarë i pengon është se në një periudhë të shkurtër do të procedohen shumë projektligje dhe do të duhej kohë më e gjatë për trajtimin e këtyre projektligjeve.

Pyeti: Cilat janë prioritetet e MPJD-së, pasi që Kosova është në një situatë mjaft delikate dhe shprehu mendimin se ka qenë një vendim i ngutshëm shkarkimi i ambasadorëve politikë në mes të mandatit.

Kadrijaj, po ashtu, tha se duhet t'i kemi qëndrimet e njëjta sa i përket politikës së jashtme dhe duhet të punojmë në drejtim të njohjes nga 5 vendet e BE-së dhe të liberalizimit të vizave.

Sa i përket Projektligjit të Diasporës, bëri të ditur se komisioni ka qenë pjesë e dëgjimeve publike dhe se ekziston një memorandum bashkëpunimi në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për hapjen e shkollave të gjuhës shqipe, por edhe për qendrat kulturore që parashihen në Projektligjin për Diasporën.

Ajo, më tej, kërkoi të informohet rreth prioriteteve të MPJD-së, se cili do të jetë angazhimi i ministres, sa i përket liberalizimit të vizave, për 5 vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën dhe vendeve tjera, si dhe sa i përket anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Donika Gërvalla, sa i përket çështjes së bashkëpunimit me komisionin, tha se do ta kërkojë vazhdimisht kontaktin me Kuvendin, sepse pa kontrollin e Parlamentit, Qeveria mund të gabojë.

Sa i përket shkarkimit të ambasadorëve, njoftoi se para se të shkonte informacioni në media, i kanë kontaktuar ambasadorët dhe i kanë falënderuar për punën e tyre.

Lidhur me Projektligjin për Diasporën, tha se defekti kryesor i këtij projektligji është se ai është përgatitur në Kosovë dhe ne duhet të shkojmë dhe të shohim se çfarë mendon mërgata, se cila është forma më e mirë e organizimit të tyre. Ne duhet të pyesim mërgatën se cilat janë nevojat e tyre, çfarë ata presin nga ne, në vend që ne si MPJD t'u tregojmë organizuesve në mërgatë sesi ne duam që ata të jenë të organizuar.

Me Republikën e Shqipërisë, tha se do të jemi të koordinuar mirë, do të fillojmë të mendojmë se cilat janë ato shtete në të cilat sipas modelit skandinav do të kemi konsullata të përbashkëta. Ka

pasur tentativa për konsullata të përbashkëta, por nuk jemi të kënaqur me rezultatet në përgjegjësi të kësaj strategjie.

Prioritetet e politikës së jashtme të kësaj Qeverie, tha se janë shteti ligjor dhe demokratik i integruar në BE dhe në NATO.

Një pjesë të madhe të potencialit njerëzor dhe kohor në MPJD, tha se është investuar në gjetjen e mënyrave për sigurimin e vaksinave në Kosovë. Kemi disa shtete, me të cilat kemi marrëdhënie të mira, të cilat na kanë premtuar që mesi i qershorit do të jetë faza kur me bollëk do të ketë vakcina në tregun ndërkombëtar. BE-ja na ka konfirmuar se me përkushtim do të na ndihmojë, mirëpo kontingjentet janë të vogla deri tani, megjithatë vaksinimi ka filluar dhe do të duhej që të vazhdojë. Kemi shikuar që të startojmë një kampanjë të përbashkët me Ministrinë e Shëndetësisë, që të lusim mërgatën tonë që para se të vijë në Kosovë, brenda mundësive që i kanë dhe në baza vullnetare, të vijë të vaksinuar.

Po ashtu, tha se prioritet tjetër i MPJD-së është përpjekja për liberalizimin e vizave. Ky proces është dëmtuar në të kaluarën dhe argumenti kryesor i shteteve skeptike në raport me Kosovën është mungesa e shtetit ligjor. Institucionet e BE-së e kanë dhënë fjalën e tyre se të gjitha kriteret janë plotësuar, por mbetën disa shtete anëtare skeptike.

Forcimi dhe thellimi i marrëdhënieve bilaterale me shtetet me të cilat kemi marrëdhënie diplomatike është një ndër detyrat kryesore që i ka MPJD-ja. Ajo njoftoi se është takuar pothuajse me të gjithë ambasadorët e vendeve që e kanë njohur Kosovën, dhe se ka vënë re se ka nevojë për shumë punë në çështjen e marrëdhënieve bilaterale me shtetet me të cilat kemi marrëdhënie dhe se thellimi i partneritetit strategjik me SHBA-në është i vetëkuptueshëm.

Lidhur me mos njohjen nga 5 vendet e BE-së tha se në MPJD ka ri aktualizuar një “Recognition Working Group”, ku profesionistët do të ulen dhe do të krijojnë një strategji, jo vetëm për njohjet brenda 5 vendeve të BE-së, por edhe të njohjeve më të gjëra. Kosova duhet të jetë e përgatitur që në momentin që bie 4 shtatori, të jetë e përgatitur për hapa substanciale në drejtim jo vetëm të njohjeve, por edhe të anëtarësimit në organizata ku nuk jemi anëtar, por në të njëjtën kohë kemi nevojë edhe për një status më të mirë brenda organizatave ku tashmë jemi anëtar.

Sa i përket organizatave ndërkombëtare siç janë Këshilli i Evropës, Karta e Adriatikut, UNESCO, Interpol dhe të tjera, tha se asnjëra prej këtyre organizatave nuk do ta harrohet, por nuk do të tentohet të rrezikohet vetëm sa për të thënë se po e provojmë. Fuqizimi i prezencës dhe përfaqësimit i Kosovës në nismat rajonale është gjithashtu i rëndësishëm. Kosova si partner i barabartë me shtetet e rajonit do të duhej të ishte pjesë integrale e nismave në rajon.

Prioritet tjetër tha se është mërgata dhe diaspora, si dhe çështja e punësimit. Mërgata jonë do të jetë urë lidhëse për investimet e huaja, të cilat do të vijë në këtë vend. Diplomacia ekonomike dhe kulturore është diçka që është lënë pas dore.

Lidhur me normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, tha se kjo qeveri nuk do t’i ikë normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, sepse konsideron se të gjitha argumentet në këtë proces, Kosova i ka në anën e vet.

Xhavit Haliti, duke u ndërlidhur me diskutimet lidhur me diplomacinë dhe shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, tha se duhet pasur parasysh faktin se ne jemi shtet i ri, që e kemi filluar ndërtimin e shërbimit diplomatik nga zero dhe koncentrimi më shumë ka qenë te përkthyesit sesa te diplomatët. Më tej, tha se me nxjerrjen e ligjit të ri për shërbimin e jashtëm, do të kemi mundësi që t’i saktësojmë disa çështje të nevojshme. Pyeti ministren: A do të vazhdojnë për ambasadorë përkthyes që kanë punuar në zyrat e huaja apo institucionet e huaja dhe a mendon që një shtetas i huaj i vendit ku jeton, mund të përfaqësojë Kosovën si ambasador në atë vend? Njëkohësisht, pyeti ministren: A i ke ftuar paraardhësit e saj ministra të Jashtëm, për të biseduar lidhur me

vazhdimësinë e punës dhe për përmirësimin e të metave të gjetura në ministri? Sa i përket marrëdhënieve diplomatike, vuri në pah avancimin e tyre me Poloninë e po ashtu edhe me Çekinë. Propozoi që krahas Akademisë Diplomatike, të kemi edhe atë për protokollin e shtetit. Lidhur me liberalizimin e vizave, theksoi se duhet kërkuar përkrahjen nga shtete që kanë mëdyshe dhe Këshilli i Ministrave mund të marrë vendimin për liberalizim të vizave, nëse kemi përkrahjen e 51% të shteteve të BE-së. Z. Haliti, po ashtu, tha se një ndër faktorët e mosliberalizimit ka qenë edhe arroganca politike e LVV-së.

Fitore Pacolli-Dalipi, theksoi se në programin e Qeverisë, figuron edhe diplomacia sportive, por shteti i Kosovës asnjëherë nuk ka pasur një strategji për diplomacinë sportive, e që është tejet e rëndësishme. Ajo kërkoj që kjo çështje të elaborohet më shumë nga ministrja, pasi që kemi sportistë të cilët përfaqësojnë denjësisht Kosovën jashtë vendit.

Adelina Grainca, lidhur me deklaratimet për reformë në shërbimin diplomatik dhe raportimeve të ndryshme për joprofesionalizmin në shërbim, kërkoj vlerësimin nga ministrja për gjendjen aktuale në ambasada dhe si do ta promovojë meritokracinë si domosdoshmëri të një administrate moderne e efektive. Dialogu është një proces i rëndësishëm i udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit. Më pas, pyeti ministren: Si e sheh rolin e MPJD-së dhe kontributin e saj, në raport me këtë proces?

Donika Gërvalla, njoftoi se ambasadorët e gjeneratës së parë dhe të dytë janë emëruar me një përzgjedhje shumë të kujdesshme, me kriteret dhe profesionalizëm. Sa i përket përkthyesve në zyra të huaja, tha se nuk e di se për kë bëhet fjalë, porse kriteret për emërimin e diplomatëve janë jo vetëm profesioni, por edhe aftësia e përfaqësimit, shkollimi, njohuritë që ka për vendin ku shkon, si dhe integriteti i tij personal. Emërimi nuk guxon të jetë çështje arbitrare, kriteret për ata që konkurrojnë duhet të jenë të njëjta për të gjithë, tha ministrja. Më tutje, theksoi se qytetarët tanë që jetojnë jashtë vendit shpesh janë përfaqësuesit më të mirë të vendit, si në jetën e tyre personale, ashtu edhe në jetën e tyre shoqërore dhe është e angazhuar që mërgatën ta përfshijë edhe në përfaqësimin institucional. Ministrja njoftoi se do të përpiket që kriteri i shtetësisë të mos jetë kriteri themelor, në bazë të të cilit do të bëhet përjashtimi i personave nga shërbimi i jashtëm. Ajo njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me kontaktet që ka pasur me ministrat pararendës, si dhe shtoi se gjendja e dokumentacionit që është gjetur në MPJD është rezultat i politikave të kaluara. Formimi i Akademisë për protokollin e shtetit, tha se është një ide e mirë, e cila duhet të diskutohet në MPJD. Në raport me Evropën, ministrja tha se ka qenë shumë e qartë në paraqitjet rreth liberalizimit të vizave. Si Qeveri duhet të japim argumente të mjaftueshme që dilema e shtetit ligjor të hiqet nga skepticizmi që mbizotëron në disa shtete rreth liberalizimit të vizave, shtoi ajo. Ministrja tha se vendimet në Këshillin Ministrave merren me konsensus, po ashtu do të punohet me shtetet e BE-së që nuk e duan liberalizimin e vizave dhe nuk do të duhej të provokohen votime të cilat rezultojnë negative. Në asnjërin nga 40 bisedat që ka pasur rreth liberalizimit të vizave, tha se nuk është përmendur qëndrimi i LVV, e cila ka kundërshtuar luftën kundër korrupsionit në vazhdimësi, por është përmendur si pengesë për mosliberalizim, prezenca dhe mosluftimi i korrupsionit. Sa i përket diplomacisë sportive, tha se ajo është e përfshirë në diplomacinë kulturore. Për gjendjen në shërbimin e jashtëm dhe meritokracinë, ministrja tha se i sheh shumë të rëndësishme që kriteret për shërbimin e jashtëm të respektohen në raport me secilin kandidat dhe zbatimi i kriterëve të përcaktuara është meritokraci. Kryeministri është bartës i mandatit për bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, e në këtë proces ndihet e përfshirë si ministre e MPJD-së, në të gjithë hapat që janë ndërmarrë deri më tani. Po ashtu, njoftoi se ka qenë e pranishme në bisedat që janë zhvilluar me z. Borrell e z. Lajçak dhe ekziston një frymë

partneriteti në qeverisje dhe koordinim shumë të mirë në mes të institucioneve që kanë kompetenca në politikën e jashtme dhe vullnet për koordinim të mirë me Kuvendin.

Dimal Basha, tha se është në dijeni se do të ketë shumë punë në MPJD dhe ka parregullsi. Ai shtroi disa çështje që kanë të bëjnë me shërbimin diplomatik dhe atë të atashëve ekonomikë. Z. Basha tha se duke pasur parasysh se nuk kemi një adresë për probleme të kompanive, si atyre vendore, ashtu edhe të atyre që gjenden në diasporë, të cilat nuk ka dikush që i ndihmon për t'i adresuar nevojat e tyre, ambasadat janë shtrirja e dorës së shtetit jashtë Kosovës. Në këtë drejtim, theksoi se është e nevojshme të formohet një grup punues pranë MPJD-së, për të hartuar një program strategjik për fuqinë ekonomike që e ka Kosova jashtë vendit.

Ariana Musliu-Shoshi, pyeti ministren: Cila do të jetë qasja ndaj Afrikës, Lindjes së Mesme, Azisë Qendrore e Amerikës Latine? Sa ambasadorë do të jenë të karrierës e sa do të jenë politikë, a do të gradohet stafi nga Ministria e Diasporës dhe çfarë do të jetë qasja ndaj tyre, qasja ndaj zotimeve të Uashingtonit të zhvilluara nga qeverisja e kaluar?

Kujtim Shala, në diskutimin e tij, mes tjerash, pyeti ministren, nëse do të bëjnë ndryshime të rëndësishme e të thella të politikës së jashtme, sepse po flitet për reforma, përfshirë edhe lirimimin nga detyra e ambasadorëve, që është përfaqësim politik. Kur kthehet një përfaqësues politik nga një përfaqësim politik diplomatik, i bie që veprimi ka domosdo edhe motivim politik. Duke pasur parasysh se ministrja nuk po artikulon vërejtje për ambasada, e pyeti atë: Çfarë i ka thënë presidentes në komunikimin formal, pasi që presidentja, brenda ditës, dekretoi lirimimin e ambasadorëve? Më tutje, njoftoi se gjatë punës së tij si zëvendëskryeministër e ministër, Kosova është anëtarësuar në 14 organizata më të mëdha sportive. Në vitin 2016, në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian është konstatuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim të vizave dhe i ka mbetur vetëm edhe një kusht, ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, të cilin ne dështuam ta bëjmë për shkak edhe të ndodhive në Kuvend, ku Kuvendit nuk i është lejuar të votojë fizikisht. Tani, a është kthyer ky kriter? Sepse, duket se Kosova ka krijuar prapë probleme në atë rrafsh dhe ato duhet të evidentohen. Kryeministri po e shpjegon si çështje të imazhit politik. Pra, nëse kërkohet sundimi i ligjit edhe për çështje të imazhit politik, është thelbësore. Sa për imazhin politik, Kosova ka ndryshuar, sepse e ka një kryeministër tjetër dhe një shumicë tjetër, që ju mbetet të punojnë. Duke u ndërlidhur me çështjen e Manastirit të Deçanit, z. Shala pyeti ministren: A do të fillojë Qeveria procedurat e regjistrimit të pronave të Manastirit të Deçanit, sipas aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese? Lidhur me marrëveshjen e parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve të vitit 2013 dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, pyeti ministren: Tani, çfarë qëndrimi ka Qeveria e Kosovës, lidhur me këtë çështje, pasi që Serbia do të tentojë ta vë në tavolinë në procesin e Brukselit?

Donika Gërvalla, lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e komisionit, tha se LVV nuk ishte pengesë për liberalizimin e vizave. Sa i përket atashëve ekonomik, njoftoi se për angazhimin e tyre nuk do të ketë një standard, por do të shikohen specifikat e secilit vend, veç e veç, sepse diku do të ketë nevojë për atashë ekonomik e diku për personel të ambasadës. Lidhur me interesimin e mërgatës dhe të investitorëve, tha se në MPJD jemi në fazën e hartimit të një koncepti, ku do të koncentrohet gjithë informacioni në një vend, të cilin mund ta kenë investitorët, kur të vijë në Kosovë. Sa i përket qasjes ndaj shteteve të kontinenteve të tjera, ministrja njoftoi se Komisioni për Çështje të Njohjeve të reja ende nuk ka paraqitur ndonjë propozim. Lidhur me gradimin punonjësve të ish- Ministrisë së Diasporës, tha se do të ishte i kundërligjshëm, sepse nevojitet ligji

i ri për fuzionimin funksional të MPJ-së dhe MD-së. Ministrja njoftoi se ambasadorët e emëruar në formën në të cilën i ka gjetur me një mbipërfaqësim të emërimeve politike ndaj atyre të karrierës, është shkelje ligji. Ajo tha se për një përfaqësim më të mirë, presidentja është pajtuar dhe kemi vendosur në parim, lirin nga detyra të personave të emëruar politikë.

- **Shqyrtim i planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2021**

Haki Abazi, njoftoj se grupi i punës për hartimin e lanit dhe programit të punës së komisionit për vitin 2021, ka hartuar një draft të planit dhe programit të punës së komisionit për vitin 2021, i cili u është shpërndarë anëtarëve të komisionit dhe Kryesia e Kuvendit i ka ngarkuar komisionet parlamentare, përmes Përfundimit nr. 08-P-015, që deri më 31 maj 2021, t'i hartojnë planet dhe programet e tyre.

Gazmend Gjyshinca, njoftoi se grupi punues është takuar më 19 maj 2021, ku është diskutuar për çështjet që duhet të përfshihen në planin dhe programin e punës së këtij komisioni për vitin 2021. Më tej, tha se drafti i planit dhe programit të punës së komisionit, parasheh shqyrtimin e projektligjeve që bien në fushëveprimin e këtij komisioni, raportimin e ministres së Punëve të Jashtme në periudha 3 mujore, raportimin e zëvendëskryeministrit, lidhur me dialogun Kosovë-Serbi dhe për liberalizimin e vizave, raportimin e ministrave të ndryshëm, sa i përket anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, organizimin e dëgjimeve publike me ambasadorë të vendeve të ndryshme, si dhe çështje tjera që bien në fushëveprimin e këtij komisioni.

Haki Abazi, propozoi që në planin dhe programin e punës së komisionit të përfshihet takimi me Komisionin Parlamentar për Integritet Evropian, për të diskutuar lidhur me liberalizimin e vizave, si dhe hapja e ueb faqes së veçantë për Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet plani dhe programi i punës së Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, për vitin 2021, me propozimet e deputetit Haki Abazi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

Haki Abazi